

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë/MinistarsvoPravde/Ministry of Justice

Kabineti i Ministrit të Drejtësisë-Ured Ministra Pravde-Office of the Minister of Justice

Nr. 330/2025

Datë: 18/07/2025

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare nr. 7/01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe në pajtim me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores (QRK) - Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Zëvendësministri në detyrë i Drejtësisë nxjerr:

V E N D I M

Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Vendimit nr.68/2025 i datës 17.03.2025

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 2.1, pika 2.2 dhe pika 2.14 e Vendimit nr. 68/2025 i datës 17.03.2025 si në vijim:


- 2.1 Feride Podvorica, MD, Kryesuese;
- 2.2 Dhurata Matoshi, DMLPPL/MD, zv. Kryesuese;
- 2.3 Fadilete Hoxha, DPSDPLS/MD, Anëtare;

2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Blerim SALLAHU
Zëvendësministër në detyrë i Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministres në detyrë të Drejtësisë;
- Sekretares së Përgjithshme;
- Anëtarëve të grupit punues;
- Departamentit për Politika të Sistemit të Drejtësisë Profesione të Lira dhe Statistika;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë;



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Kancelarija Ministra Pravde - Cabinet of the Minister of Justice

Nr. 68/2025

Datë: 17/03/2025

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (GZ, nr. 7, 01 Mars 2019), duke u bazuar të nenin 11 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenin 31 (paragrafin 1) të Rregullores (QRK) - Nr. 17/2024 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe në pajtim me shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores QRK-Nr 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Grupi Punues për hartimin dhe finalizimin e Projekt akteve nënligjore që rrjedhin nga Ligji Nr. 08/L-272 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/-10 për Noterinë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-149, si në vijim:

1.1 Projekt Udhëzim Administrativ për mënyrën e mbajtjes së trajnimit, kushtet për të trajnuarit, kompensimin, si dhe rregullat për kandidatët të cilët e kanë kaluar provimin për noterë;

1.2 Projekt Udhëzim Administrativ për mënyrën, përgjegjësinë, autorizimet dhe të drejtat e qasjes së noterëve në sistemin informativ noterial si dhe shkëmbimin e informatave me institucionet e tjera;

1.3 Projekt Udhëzim Administrativ për mënyrën e mbajtjes së dokumenteve që krijohen në formë elektronike;

1.4 Projekt Udhëzim Administrativ për Regjistrin Elektronik të Testamenteve;

1.5 Projekt Udhëzim Administrativ për nënshkrimin elektronik noterial;

1.6 Projekt Udhëzim Administrativ për qasjen elektronike dhe shfrytëzimin e regjistrave publik.

2. Grupi punues nga pika 1 e këtij vendimi, përbëhet nga:

2.1 Fadilete Hoxha, DPSDPLS/MD, Kryesuese;

2.2 Feride Podvorica, DL/MD, zv. Kryesuese;

2.3 Përfaqësues nga Kabineti i Ministres/MD- Anëtar;

- 2.4 Elbasan Dervishaj, DPSDPLS/MD, Anëtar;
- 2.5 Alberita Hyseni, ZL/ZKM, Anëtare;
- 2.6 Përfaqësues nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Anëtar;
- 2.7 Përfaqësues nga Oda e Noterëve të Kosovës, Anëtar;
- 2.8 Përfaqësues nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit; Anëtar;
- 2.9 Përfaqësues nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, Anëtar;
- 2.10 Burbuqe Spahija Kërveshi, DPSDPLS/MD, Anëtare;
- 2.11 Besa Krasniqi, DPSDPLS/MD, Anëtare;
- 2.12 Serije Makolli, DL/MD, Anëtare;
- 2.13 Fjolla Sojeva Sopi, DBF/MD, Anëtare;
- 2.14 Dhurata Matoshi, DMLPPL/MD, Anëtare;

3. Sipas nevojës dhe me qëllim të realizimit të obligimeve të përcaktuara me këtë vendim, Kryesuesi i Grupit Punues mund të ftojë edhe përfaqësues të tjerë përfshirë institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare si dhe organizatat e shoqërisë civile.

4. Grupi Punues nga pika dy (2) e këtij vendimi obligohet ti përmbahet rregullave dhe procedurave të përcaktuara me Rregulloren Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Kosovës dhe standardeve në fuqi për hartimin e legjislacionit.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;
- Anëtarëve të grupit punues;
- Departamentit për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika dhe
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.